



### **Vështrim i përgjithshëm**

Studentëve u kërkohet të përdorin vetëm pajisje elektronike të ofruara nga distrikti gjatë seancave të testimit. Studentëve nuk u lejohet përdorimi i pajisjeve elektronike personale, jo-testuese kur janë në një seancë aktive testimi ose gjatë pushimit.

### **Shembuj të Pajisjeve Elektronike**

Shembujt e pajisjeve elektronike përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm me:

- Çdo pajisje elektronike që mund të përdoret për të regjistruar, transmetuar ose marrë informacion, që nuk përdoret për testim, tablet, kompjuter, iPad, Lexues elektronik (për shembull: Kindle)
- Orë Inteligjente (për shembull: Fitbits; Apple, Garmin, Samsung Watches; çdo lloj ore me qasje në aplikacione të tjera ose në internet)
- Telefonat Inteligjentë dhe Celularë
- Kufje Bluetooth, kufje inteligjente (për shembull: Beats, iPod) ose çdo kufje me qasje në aplikacione të tjera ose në internet)
- Syze inteligjente (për shembull: Google Glass)
- Kompjuterë, laptopë, që nuk përdoren për testim

### **Protokollet për Studentët**

Të gjitha pajisjet personale të studentëve duhet të lihen në shtëpi ose do të mbahen në një vend të sigurt siç përcaktohet nga administratori i objektit për të gjitha testimet shtetërore.

Studentët nuk lejohen të përdorin, veshin ose kenë qasje në asnjë pajisje elektronike personale, jo-testuese gjatë testimit ose gjatë pushimit ndërkohë që një seancë aktive testimi është në zhvillim e sipër. Këto pajisje elektronike përfshijnë, por nuk kufizohen me telefonat inteligjentë ose celularë, orët inteligjente, kufjet Bluetooth, kufjet që lejojnë qasje në teknologjinë e asistentit zanor dhe kompjuterët ose tabletët që nuk po përdoren në mënyrë aktive për testimin. Nëse ndonjë pajisje elektronike personale sillet në mjedisin e testimit, anëtar i stafit do ta marrë, do të fikë pajisjen, do ta etiketojë atë me emrin e studentit dhe do ta vendosë në një vend të sigurt.

Nëse një pajisje elektronike është e nevojshme për arsye mjekësore për një student që po testohet, pajisja duhet t'i lihet administratorit të testit ose testi duhet t'i administrohet studentit në një mjedis testimi që përfshin një administrator dhe një student dhe ku studentit monitorohet në mënyrë aktive gjatë gjithë kohëzgjatjes së testimit.

### **Gjithashtu:**

- Studentëve nuk u lejohet të përdorin pajisjen e përdorur për testim për ndonjë qëllim tjetër përveçse për të përfunduar testin gjatë sesionit të testimit.
- Një student nuk mund të hyjë në asnjë faqe interneti ose aplikacion shtesë gjatë testimit, ose për ndonjë qëllim tjetër pas testimit, ndërsa është në dhomën e testimit.
- Stafi duhet të sigurojë që të gjitha pajisjet e testimit janë konfiguruar siç duhet dhe se të gjitha aplikacionet e tjera janë çaktivizuar përpara se të fillojë testimi.
- Gjatë testimit nuk mund të bëhen fotografi ose regjistrohen video.

Studentëve që sjellin pajisje elektronike në dhomën e testimit ose qasen tek këto pajisje gjatë testimit do t'u anulohet testi.

## **Protokollet për Administratorët/Vëzhguesit e Testit dhe Stafin**

Stafi do të lejohet të sjellë pajisjen(et) e tyre personale në mjedisin e testimit. Pajisja duhet të vendoset në heshtje dhe të mbahet mbi personin e tyre, në mënyrë që të jetë jashtë shikimit dhe të mos qaset nga studentët.

Administratori i testit nuk duhet të shqetësojë mjedisin e testimit duke folur ose komunikuar me mesazhe, përdorur telefona celularë/teknologji të veshura/pajisje elektronike të tjera, me përjashtim të një rasti urgjent brenda dhomës së testimit. Stafi mund të përdorë vetëm një pajisje elektronike të konfiguruar siç duhet për të monitoruar testimet shtetërore, sipas rregullit. Pajisjet elektronike nuk duhet të përdoren për asnjë qëllim tjetër, gjatë testimit.

Qasja në një pajisje elektronike shtesë në kundërshtim me protokollin e përdorimit të pajisjeve elektronike të Utica Community Schools për testimin shtetëror do të rezultojë në keqadministrim për të gjithë seancën e testimit dhe pavlefshmëri të testeve të studentëve, plus çdo mase tjetër që Departamenti i Arsimit i Miçiganit i konsideron të nevojshme.

### **Plani i komunikimit**

Anëtarët e stafit do të lexojnë dhe rishikojnë me studentët Protokollin e përdorimit të Pajisjeve Elektronike të Utica Community Schools për testimin shtetëror përpara testimit, dhe do të kontrollojnë për mirëkuptim. Anëtarët e stafit do të dokumentojnë datën dhe orën kur përfundon ky proces.

Protokollet do t'u komunikohen drejtpërsëdrejti studentëve dhe do të shpërndahen në buletinet e shkollave, në faqen e internetit të qarkut dhe do të referohen në të gjitha letrat e testimit dhe të gjitha komunikimet e tjera për familjet në lidhje me testimin shtetëror. Përveç kësaj, komunikimet do të përkthehen në gjuhë të tjera që fliten në distrikt.

Anëtarët e stafit të përfshirë në testimin shtetëror duhet të ndjekin trajnimin për testimet shtetërore të ofruar nga qarku përpara administrimit të testit shtetëror. Protokollin e përdorimit të pajisjeve elektronike të Utica Community Schools për testimet shtetërore do të përfshihet në të gjitha seancat e trajnimit dhe në të gjitha materialet e trajnimit.

### **Vëzhgimi**

Stafi i administrimit duhet të tregojë kujdesin e duhur në vëzhgimin aktiv të studentëve në dhomën e testimit dhe në kohët e pushimit për të siguruar që ata të mos kenë qasje tek pajisjet e tjera elektronike. Stafi duhet të verifikojë në mënyrë aktive që asnjë student nuk përdor pajisje elektronike shtesë, përpara, gjatë dhe pas testimit.

Stafi do të nxisë studentët të sigurohen që nuk kanë asnjë pajisje elektronike përpara administrimit të testit. Shembull: "A keni kufje në vesh apo në xhep?" "A keni një orë inteligjente?" "A keni një telefon në xhep?"

### **Plani i raportimit të incidenteve**

Administratori i testimit duhet të raportojë rastet kundërvajtësve të mbajtjes së pajisjeve elektronike tek administratori i objektit. Administratori i objektit do të telefonojë koordinatoren e testeve të qarkut për të raportuar incidentin dhe do të dorëzojë një raport me shkrim brenda 24 orëve nga incidenti. Koordinatorin e testeve të qarkut do të paraqesë një raport incidenti dhe do të njoftojë administratorët e tjerë të qarkut sipas rastit.

### **Pasoja për nxënësit në rastet e shkeljes së protokolleve**

Nëse një nxënës ka qasje në një pajisje elektronike dhe/ose teknologji "të veshur" përveç pajisjeve të testimit, në çfarëdo momenti gjatë një seance testi, edhe në rastet kur nxënësi ka dalë ose ka dorëzuar testin, testi i atij studenti është komprometuar dhe do të konsiderohet i pavlefshëm për arsye të një veprimi të ndaluar, edhe nëqoftëse studenti nuk e ka përdorur pajisjen elektronike. Nxënësi duhet të largohet nga mjedisi i testimit dhe prindi ose kujdestari do të informohet për incidentin. Përveç shkeljes së kësaj rregulloreje, studentët do t'i nënshtrohen masave disiplinore të shkollës deri në pezullim ose përjashtim për shkeljen e rregullores së qarkut për përdorimin e teknologjisë (District Acceptable Use of Technology Policy) dhe rregulloren e sjelljes së nxënësve (Student Code of Conduct).

## Pasojat për Stafin në rastet e Shkeljes se Protokolleve

Nëse një administrator testimi ose një anëtar tjetër i stafit në dhomën e testimit qaset tek një pajisje elektronike jo-testuese dhe/ose fotografon/komunikon përmbajtje të testit, kjo do të rezultojë në një keqadministrim për të gjithë seancën e testimit dhe në pavlefshmëri të testeve të studentëve. Përveç kësaj, mund të ndërmerren masa të tjera nga administrata e qarkut dhe/ose Departamenti Arsimor i Miçiganit (MDE) sipas rastit.

## Burime

- Rregullorja e përdorimit të pajisjeve (OEAA 2022-2023 Electronic Device Use Policy)
- Udhëzuesi i Departamentit Arsimor të Miçiganit për Integritetin e Testimeve (Michigan Department of Education Assessment Integrity Guide)
- Rregullorja 6600 e Bordit Arsimor të Utica Community Schools.
- Të rejtat nga qarku
- Të rejtat nga shkolla
- Faqja e internetit e qarkut
- Njoftimet/letrat e dërguara rreth testimeve
- Perkthyesit
- Parent and Student Handbook 2022-2023 të Utica Community Schools

## Trajnimi i nevojshëm i personelit

Anëtarët e stafit të përfshirë në testimin shtetëror duhet të ndjekin trajnimin për testimet shtetërore të ofruar nga qarku përpara administrimit të testit shtetëror. Protokollin e përdorimit të pajisjeve elektronike të Utica Community Schools për testimet shtetërore do të përfshihet në të gjitha seancat e trajnimit dhe në të gjitha materialet e trajnimit.

## Linja Kohore

Shtator 2022	<ul style="list-style-type: none"><li>• Takimet e Ekipit të Drejtuesve të Qarkut</li></ul>
Tetor 2022	<ul style="list-style-type: none"><li>• Prezantim për Kabinetin dhe Këshillin e Drejtuesve të Programit të Qarkut</li></ul>
Janar 2023	<ul style="list-style-type: none"><li>• Sesion trajnimi për administratorët e objekteve dhe koordinatorët e testimit</li><li>• Sesion trajnimi për vëzhguesit e testimit WIDA</li><li>• Komunikim me familjet e nxënësve që marrin pjesë në testimin WIDA</li><li>• Prezantim për studentët pjesëmarrës në testimin WIDA</li></ul>
Shkurt 2023	<ul style="list-style-type: none"><li>• Administrim i testimit WIDA me zbatim të plotë të Protokollit të Përdorimit të Pajisjeve Elektronike të Utica Community Schools për Testimet Shtetërore</li></ul>
Mars 2023	<ul style="list-style-type: none"><li>• Sesion trajnimi për të gjithë vëzhguesit e testimeve finale shtetërore</li><li>• Komunikimi me familjet e nxënësve pjesëmarrës në testet shtetërore</li><li>• Prezantim për nxënësit pjesëmarrës në testimet finale shtetërore</li></ul>
Prill 2023	<ul style="list-style-type: none"><li>• Administrim i testimit final me zbatim të plotë të Protokollit të Përdorimit të Pajisjeve Elektronike të Utica Community Schools për Testimet Shtetërore</li></ul>